

VËREN:

Në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, në datë 31.01.2019 ora 15:40, është paraqitur për gjykim kërkesa e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, me objekt caktimin e masës së sigurimit personal shtrëngues "arrest në burg", parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, për shtetasit nën hetim përmëndur më sipër, pasi dyshohen se kanë kryer veprën penale "Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave", "Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve", "Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve" dhe "Grupi i strukturuar kriminal", parashikuar nga nenet 189, 190, 298 dhe 333/a të Kodit Penal.

I. Rrethanat e çështjes dhe provat e paraqitura nga prokuroria në mbështetje të kërkesës:

Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me datë 22.11.2016, është referuar materiali hetimor, mbi ekzistencën e një grupi kriminal në drejtim të ndihmës për kalim të paligjshëm të kufirit, parashikuar nga nenet 298/3, 333/a e 334 të K.Penal. Këto materiale janë regjistruar dhe njohur me numër procedimi penal 272/2016.

Nga studimi i materialit referues si dhe nga hetimet e kryera ka rezultuar Nisur nga informacionet e dërguara në burime të ndryshme, si nga policia e shtetit dhe policia gjyqësore e seksionit të Prokurorisë për Krime të Rënda, janë mbledhur të dhëna të mjaftueshme që të krijojnë dyshime se disa shtetas në bashkëpunim me njëri-tjetrin dhe persona të tjerë kryejnë falsifikime të dokumenteve, si letërnjoftime, pasaporta, viza si dhe duke i pajisur me dokumente të falsifikuara në shërbim të personave të ndryshëm kundrejt përfitimit monetar dhe material dhe nëpërmjet linjave ajrore dhe linjave të tjera të udhëtimit, trafikojnë shtetas të ndryshëm për në shtete të ndryshme, kryesisht, SHBA, Kanada dhe Mbretëria e Bashkuar etj.

Nga veprimet hetimore të kryera në funksion të procedimit penal, rezulton se shtetasit Ilir Myrtaj, Alfred Myrtaj, Marjo Myrtaj, Albert Xhelili, Gentjan Stojku, Florjan Hysenaj, Entela Cala, Keldi Beshi, Arben Kadiu, Ismail Alushani, Ylli Gokaj, Aleksandër Leka, Shkelqim Mema, Qazim Hysko, në bashkëpunim me njëri-tjetrin në kuadër të grupit të strukturuar kriminal gjejnë persona të ndryshëm të cilët kanë interes për të udhëtuar në shtetet e pershkruar me sipër, shtetas shqiptar dhe të huaj, të cilët pasi i pajisnin me dokumente identifikimi të falsifikuar, kundrejt përfitimit monetar, i nisnin në mënyrë të paligjshme drejt SHBA-së, Kanadasë, Mbretërisë së Bashkuar etj, me linjat e udhëtimit me mjete të ndryshme dhe me linja ajrore. Nisja e personave me dokumente të falsifikuar bëhej nga Republika e Shqipërisë, Mali i Zi, Italia, Greqia, Franca dhe Norvegjia.

Në funksion të këtij hetimi janë dokumentuar disa episode ku personat e mesipër, kanë falsifikuar dokumente të udhëtimit dhe kanë dhene ndihme për kalim të paligjshëm të kufirit të disa shtetasve nder të cilet dhe për shtetasi Vera Mehmetaj, Limos Selimi dhe Rezalba Hotaj, të cilët kanë udhëtuar nga Shqipëria për në SHBA dhe

Kanada, duke përdorur pasaporta dhe viza të falsifikuara. Anëtarët e këtij grupi kriminal për këtë aktivitet të paligjshëm merrnin në këmbim nga personat e trafikuar shuma të konsiderueshme të vlerave monetare që varionte deri në 20 mijë euro për person. Gjithashtu nga të dhënat e administruara ka rezultuar se anëtarët e këtij grupi kriminal paisnin shtetas të huaj kryesisht nga Lindja e Mesme dhe Kina dhe me pas i trafikonin drejt vendeve të BE, Mbretërisë së Bashkuar, Sh.B.A dhe Kanadase.

Ndërkohë, gjatë hetimit të këtij procedimi penal në bashkëpunim me organet e tjera ligjzbatuese janë marrë të dhëna për faktin se pjesëtarë të tjerë të këtij grupi kriminal e kryenin këtë aktivitet kriminal edhe në shtetin grek, ku Autoritetet Policore Greke kanë arritur të bëjnë arrestimin e 16 personave si anëtarë të këtij grupi kriminal, si dhe janë sekuestruar gjashtë laboratore prodhimi dokumentesh të falsifikuara. Nga këto biseda telefonike rezultojnë të dhëna se shtetasi Alfred Myrtaj bashkëpunon me pjesëtarë të këtij grupi kriminal në shtetin grek, lidhje e të cilëve është edhe shtetasi Gentjan Stojku. Nga të dhënat e marra nga policia gjyqesore dhe agjensitë ligjzbatuese rezulton se 24 anëtarët e tjerë që kishin lidhje me këtë grup kriminal janë arrestuar nga Autoritetet Policore Greke me datë 31.10.2017 dhe 01.11.2017, ndaj të cilëve vazhdojnë hetimet nga organi procedues grek. Në lidhje me këtë fakt nga ana jonë është dërguar letërporosi Autoriteteve Greke të Drejtësisë për marrjen e akteve të këtij procedimi penal.

Nga hetimet e kryera rezulton se shtetasi Albert Xhelili, kryen rolin e ndermjetësit me shtetasit Alfred Myrtaj dhe Ilir Myrtaj, për prodhimin e dokumenteve, pasaportave, kartave të identitetit dhe patentave të falsifikuara të cilat shiten me vlerën nga 10.000 Euro deri në 20.000 Euro. Nga pergjimi i numrave të telefonit rezulton se Alfredi, Ilir, Marjo dhe Berti janë bashkëpunorë të ngusht në prodhimin e dokumenteve të falsifikuara.

Nga hetimet e kryera ka rezultuar se shtetasi Albert Xhelili ka bashkëpunuar me shtetasin Florjan Hyseni lindur dhe banues në Shkodër i cili disponon dhe perdorë në të gjitha bisedat telefonike numrin e telefonit **0692478491**. Në bisedën e bërë mes tyre me datë 15.02.2018 rezulton se shtetasi Florjan Hyseni vjen në Tiranë dhe i kërkon ndihmë Albertit për t'i përgatitur një pasaportë të falsifikuar, me emer të një shtetasi italiane, Claudia Ambrogi, me fotografi të një vjaze nga Shkodra, e cila donte të shkonte në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Me datë 17.02.2018 shtetasi Florjan Hyseni (i prezantuar si Flor Isufi) ka ardhur në Tiranë ka takuar shtetasin Albert Xhelili i cili i ka dorëzuar pasaportën dhe të gjitha dokumentet e falsifikuara, të cilat Florjani i kishte porositur me datë 15.02.2017. Pasi ka pirë një kafe afer vendit të quajtur Zogu i Zi ka ikur në këmbë tek stacioni i autobusit dhe është nisur për në qytetin e Shkodrës. Gjatë rrugës për në Shkodër shërbimet e policisë e kanë ndaluar autobuzin duke kryer një kontroll të imtësishëm të shtetasit Florjan Isufi dhe ka rezultuar se Florjani kishte në xhep pasaportën në emer të shtetases italiane Claudia Ambrogi dhe një flete letër të bardhë ku kishte të shënuara të dhënat që shtetasi Florja Hyseni i kishte dhënë shtetasit Albert Xhelili, ku rezulton se janë të njëjta me pasaportën. Pasi u konstatua ky fakt u la lirë së bashku me pasaportën dhe dokumentet e falsifikuara të cilat i mbante në xhepë.

Nga të dhënat e marra nga agjensitë ligjzbatuese ka rezultuar se një shtetase Shqiptare nga rrethinat e Shkodrës është ndaluar në një aeroport nderkombëtar duke ikur për në SHBA me pasaportën që kishte prodhuar shtetasi Ilir Myrtaj dhe Alfred Myrtaj, që ishte dhënë shtetasit Albert Xhelili. Alberti, pasi e merr pasaportën e falsifikuar njofton shtetasin Florjan Hyseni nga Shkodra i cili ishte porositësi, që të vijë në Tiranë për ta marrë dhe rezulton se vjen po këtë ditë dhe Alberti ja dorëzon pasaportën e falsifikuar.

Gjatë kohës së shoqërimit të shtetasit Kledi Beshi dhe Shkëlqim Mema, nga policia, tek vendi ku ishte ulur shtetasi Kledi Beshi, është gjetur e fshehur poshtë tapicerisë së këmbëve të pasagjerit në vendin pas shoferit, një dokument në gjuhën Italiane në emër të shtetasit Andrea Fanton me datëlindje 21.01.1989 dhe 16 fotografi të katër personave të ndryshëm, shenime në copa letre për prollime dokumentesh një i perket shtetasit Pjeter Martin Thani.

Gjithashtu gjatë kontrollit të studios "Alushani" janë gjetur dhe sekuestruar në cilësine e proves materiale kompjutera, printera, USB, DVR, hradisqe dhe sende të tjera të cilat dyshohet se përdoren për prodhimin e falsifikimit të dokumentave. Nga hetimet e kryera rezultoi se shtetasi Ismail Alushani bashkëpunonte me shtetasin Alfred Myrtaj dhe pjestare të tjera të këtij grupi kriminal dhe dyshohet se në ambientet e studios të këtij shtetasi kryhen falsifikime.

Gjatë hetimit të procedimit penal rezultoi se shtetesia shqiptare **Rezalba Hotaj** e datelindjes 10.06.1996 është kapur në flagrancë në Xhamajkë duke udhëtuar për në Toronto me Air Canada me pasaportë amerikane të falsifikuar në emër të shtetases amerikane **Issabella Gutieres** e datelindjes 14.06.1996. Gjithashtu shtetasi shqiptar **Limos Selimi** i datelindjes 01.11.1992, është kapur në flagrancë në Xhamajkë duke udhëtuar për në Toronto me Air Canada me pasaportë amerikane të falsifikuar në emër të shtetasit amerikan **Mark Johnson** i datelindjes 20.11.1990.

Sa më sipër, me urdhër të prokurorit të datës 14.05.2018, duke qenë se ndodheshim para rasteve të parashikuara nga neni 253/1 të Kodit të Procedurës Penale, është vendosur ndalimi i shtetasve **Illir Myrtaj, Alfred Myrtaj, Marjo Myrtaj, Gentjan Stojku, Florjan Hysenaj, Keldi Beshi, Arben Kadiu, Ismail Alushani, Ylli Gokaj, Shkëlqim Mema, Rezalba Hotaj, Vera Mehmetaj, Albert Xhelili** si persona të dyshuar për kryerjen e këtyre veprave penale më sipër.

Gjykata e Shkallës së Parë për krime të Rënda Tiranë me vendim **nr.102, datë 18.05.2018**, vleftësoi të ligjshëm ndalimin e personave më sipër dhe caktoi masat e sigurimit personal ndaj personave të dyshuar, **Illir Myrtaj, Alfred Myrtaj, Marjo Myrtaj, Gentjan Stojku, Florjan Hysenaj, Keldi Beshi, Arben Kadiu, Ismail Alushani, Ylli Gokaj, Shkëlqim Mema, Rezalba Hotaj, Vera Mehmetaj, etj**, të dyshuar për kryerjen e veprave penale "Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave", "Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve", "Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve" dhe "Grupi i strukturuar kriminal", parashikuar nga nenet 189, 190, 298 dhe 333/a i K.Penal.

Gjatë hetimit të këtij procedimi penal janë sekuestruar disa prova materiale, dokumenta të falsifikuar dhe 4 laboratore, njësi kompjuterike, të cilët dyshoheshin se përdoren për prodhimin e dokumenteve të falsifikuara. Lidhur me këto po kryhen ekspertimet dhe po bëhet analizimi i të gjitha të dhënave të përfutuara nga këto ekspertime.

Nga studimi i materialit referues si dhe nga hetimet e kryera ka rezultuar se disa shtetas shqiptarë nga Shqipëria në bashkëpunim me shtetas të tjerë jashtë Shqipërisë, janë organizatorë të një grupi kriminal ku bëjnë trafikim personash kryesisht në linjën SHBA-Kanada-Mbretëri e Bashkuar. Në Shqipëri ndër të tjera janë identifikuar disa grupe personash të cilët në kuadrin e një grupi të strukturuar kriminal, kanë një bashkëpunim të qëndrueshëm kryesisht me shtetas Grek në kryerjen e kësaj veprimtarie kriminale.

Sipas urdhërit për rregjistrimin e personit që i atribuohet vepra penale, në rregjistrin penal në datën 30.01.2019, prokurori Vladimir Mara pranë Prokurorisë për Krime të Rënda Tiranë, rregjistroi në regjistrin e njoftimit të veprave penale të

Shtetasi Florjan Hyseni (Isufi) të njëtin mekanizëm ka kryer edhe në lidhje me pasaportën që ka pergaditur për shtetasen Vera Xhyher Mehmetaj e cila donte të ikte për në Kanda tek i fjeuari i saj i cili banon atje. Sapo ka marrë pasaportën e flasifikuar me foton e Verës dhe me të dhënat e një shtetasje të huaj ka ikur e shoqëruar nga babai i sajë Xhyheri dhe nga shtetasi Ylli Xhemal Gokaj i cili ka një makinë me targa AA562IT ku e shoqëron deri në aeroportin e Potgoricës në Malin e Zi me datë 16.03.2018 dhe pasi shkon në njërin nga Aeroportet nderkombëtare e kthejne në Aeroportin e Malit të Zi me datë 27.03.2018 si të deportuar dhe perseri shkojnë për ta marrë Verën në Aeroportin në Malin e Zi, babai i saj, Xhyheri dhe shtetasi Ylli Gokaj, me mjetin me targa AA562IT, ku gjatë udhëtimit të tyre, në rrugën nacionale të Hanit të Hotit Shkodër kanë bërë aksident automobilistik.

Pra nga hetimi i kryer rezulton se shtetasi Florjan Hyseni ka disa raste bashkëpunimi me shtetasit Ilir Myrtaj dhe Alfred Myrtaj. Për prodhimin e dokumenteve të falsifikuara shtetasi Florjan Hyseni ka bashkëpunuar edhe me shtetasin Arben Kadiu. Nga vëzhgimi i lëvizjeve të këtyre personave, rezulton se shtetasit Arben Kadiu dhe Florjan Hysenaj janë takuar me njëri-tjetrin tek një lokal përballë gjimnazit Harry Fultz, në zonën e unazës, Tiranë, ku është konstatuar se shtetasi Arben Kadiu i ka dhene shtetasit Florjan Hysenaj dy pasaporta dhe me pas kanë numëruar një sasi të konsiderueshme parash.

Me datë 05.11.2017, shtetasi nën hetim Shkelqim Mema nëpërmjet numrit të telefonit 06936944605 ka biseduar me një shtetas i cili është prezantuar si Adritatik Aga me numer telefoni italian 00393473247168. Nga biseda rezulton se Shkelqimi i ka pergatitur dhe i ka dhene kunatit të Adriatikut një dokument të flasifikuar të cilin e kishte dërguar kunati i Adriatikut në Itali. Për këtë punë të bërë Adriatiku i dergon Shkelqimit një shumë prej 200 Eurosh, të cilën Shkelqimi i terheq prani Institucionit Financiar AK INVEST.

Nga biseda e bërë nga Shkelqimi me datë 04.11.2017 me një person tjetër me numer telefoni 0699184141, bëhet bisedë mes tyre për prodhimin e një pasaporte tjetër të falsifikuar, ku do të shkonte ta merrte vetë personi tek Shkelqimi, rezulton se është pasaportë dhe ky do vente për ta marrë dhe për ta bërë vetë.

Nga vëzhgimi i lëvizjeve të personave të dyshuar, rezulton se shtetasit Aleksander Peçi (Leka) dhe Albert Xhelilaj janë takuar me njëri-tjetrin në zonën e unazës, përbadhë pallateve Kajtazi në afersi të Bar Snap Kafe, para Hotel Doros ku ka marrë zarfe me dokumunte të dhëna nga shtetasi Albert Xhelili. Nga hetimet dhe nga këqyrja e banesës së shtetasit Alfred Myrtaj ka rezultuar se aty kishte një lobaratore që prodhonte dokumente të falsifikuara. Shtetasi Alfred Myrtaj prodhonte dokumet e falsifikuara dhe ja jepte për ti shperndarë shtetasit Albert Xhelilaj i cili takohej me shtetasin Aleksander Peçi.

Në momentin që u bë ndalimi nga policia gjyqesore e një grupi kriminal që kryente falsifikime dokumentesh në Tiranë, shtetasi Florjan Hysenaj ju shmang grupit të drejtuar nga Alfred Myrtaj dhe Albert Xhelili, të cilët bënin pasaporta dhe dokumente të falsifikuara, gjeti personin tjetër që do e pajiste me dokumente të falsifikuara. Gjatë kësaj kohe ai nisi të takohej me shtetasin Arben Kadiu. Shtetasi Arben Kadiu ka komunikuar dhe është takuar në vijimsi me shtetasin Keldi Beshi, Shkelqim Mema dhe Qazim Hysko. Nga vëzhgimi rezulton se me datë 15.02.2018 shtetasi Keldi Beshi është takuar me shtetasin Albert Xhelilaj, pasi ky i fundit kishte marrë një porosi të futur në një zarf të bardhë të derguar nga shtetasi Florjan Hysenaj. Këtë zarf, Florjani e kishte derguar në Tiranë me një autobus të linjës Shkoder-Tiranë. Alberti, pasi e merr zarfin e derguar nga Florjani, takon shtetasin Keldi Beshi.



**GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
PËR KRIME TË RËNDA
TIRANË**

Nr. 18 Akti
Dt.Regjistrimi 31.01.2019

Nr.Vendimi 18
Dt. Vendimi 02.02.2019

VENDIM

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, e përbërë prej:

Gjyqtare – IRENA GJOKA

asistuar nga sekretare gjyqësore **Blerta Martini**, në Tiranë, sot në datën **02.02.2019**, dite e Shtunë, ora **09:30**, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi kërkesën penale me nr.regj.themeltar 18, datë regjistrimi 31.01.2019 që i përket:

KËRKUES: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, përfaqësuar në paraqitjen e kërkesës nga prokurori **Vladimir Mara**.

KUNDËR: PERSONA NËN HETIM

1- Dritan Gramozi, i biri i Janaq dhe i Spira, i datëlindjes 17.09.1974, lindur dhe banues në Stjar, Delvinë, i martuar, me shtetësi shqiptare.

I dyshuar: Për kryerjen e veprave penale “Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave”, “Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve”, “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve”, “Grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga nenet 189, 190, 298 dhe 333/a të K.Penal.

2- Arjan Shehu, i biri i Sefer dhe i Ëngjëllushe, i datëlindjes 30.03.1973, lindur dhe banues në Toç, Tepelenë dhe banues në Tiranë, i martuar, me shtetësi shqiptare.

I dyshuar: Për kryerjen e veprave penale “Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave”, “Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve”, “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve”, “Grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga nenet 189, 190, 298 dhe 333/a të K.Penal.

3- Simon Këri, i biri i Kristaq dhe i Lenë, i datëlindjes 25.08.1959, lindur në Sqepur, Berat dhe banues Tiranë, i martuar, me shtetësi shqiptare.

I dyshuar: Për kryerjen e veprave penale “Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave”, “Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve”, “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve”, “Grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga nenet 189, 190, 298 dhe 333/a të K.Penal.

4- Rezart Hoxha, i biri i Spartak dhe i Safo, i datëlindjes 01.05.1976, lindur në Gjikokastër, dhe banues në Gjirokastër, i martuar, me shtetësi shqiptare.

I dyshuar: Për kryerjen e veprave penale "Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave", "Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve", "Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve", "Grupi i strukturuar kriminal", parashikuar nga nenet 189, 190, 298 dhe 333/a të K.Penal.

5- Dashamir Seferi, i biri i Adem dhe i Veziko, i datëlindjes 18.12.1984, lindur në Krahës i Sipërm, Tepelenë dhe banues në Gjirokastër, i martuar, me shtetësi shqiptare.

I dyshuar: Për kryerjen e veprave penale "Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave", "Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve", "Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve", "Grupi i strukturuar kriminal", parashikuar nga nenet 189, 190, 298 dhe 333/a të K.Penal.

6- Leonard Markaj, i biri i Petro dhe i Pinellopi, i datëlindjes 25.05.1958, lindur në Përmet dhe banues në Përmet, i martuar, me shtetësi shqiptare.

I dyshuar: Për kryerjen e veprave penale "Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave", "Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve", "Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve", "Grupi i strukturuar kriminal", parashikuar nga nenet 189, 190, 298 dhe 333/a të K.Penal.

7- Astrit Ziguri, i biri i Eqerem dhe i Nadile, i datëlindjes 20.07.1971, lindur në Delvinë dhe banues në Stjar, Delvinë, i martuar, me shtetësi shqiptare.

I dyshuar: Për kryerjen e veprave penale "Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave", "Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve", "Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve", "Grupi i strukturuar kriminal", parashikuar nga nenet 189, 190, 298 dhe 333/a të K.Penal.

8- Edmond Omeri, i biri i Rushit dhe i Neho, i datëlindjes 02.06.1967, lindur në Vërvë, Sarandë dhe banues në Sarandë, i martuar, me shtetësi shqiptare.

I dyshuar: Për kryerjen e veprave penale "Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave", "Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve", "Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve", "Grupi i strukturuar kriminal", parashikuar nga nenet 189, 190, 298 dhe 333/a të K.Penal.

9- Kostaq Gjoka (alias Lonidha), i biri i Konstandin dhe i Dhoksi, i datëlindjes 16.07.1967, lindur dhe banues në Korçë, i dicorcuar, me shtetësi shqiptare.

I dyshuar: i dyshuar për kryerjen e veprave penale "Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave", "Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve", "Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve", "Grupi i strukturuar kriminal", parashikuar nga nenet 189, 190, 298 dhe 333/a të K.Penal.

10- Arben Danglli, i biri i Agim dhe i Kote, i datëlindjes 05.11.1965, lindur në fshatin Menkulas, Korçë dhe banues në Korçë, i martuar, me shtetësi shqiptare.

I dyshuar: Për kryerjen e veprave penale "Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave", "Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve", "Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve", "Grupi i strukturuar kriminal", parashikuar nga nenet 189, 190, 298 dhe 333/a të K.Penal.

- 11- Petrit Beqiraj**, i biri i Hasan dhe i Dhimitrulla, i datëlindjes 30.05.1960, lindur në Delvinë, Sarandë dhe banues në Vlorë, i martuar, me shtetësi shqiptare.
I dyshuar: Për kryerjen e veprave penale "Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave", "Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve", "Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve", "Grupi i strukturuar kriminal", parashikuar nga nenet 189, 190, 298 dhe 333/a të K.Penal.
- 12- Glej alias Edison Shehu**, i biri i Mihal dhe i Urani, i datëlindjes 26.12.1987, lindur në Krahës, Tepelenë dhe banues në Tiranë, i martuar, me shtetësi shqiptare.
I dyshuar: Për kryerjen e veprave penale "Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave", "Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve", "Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve", "Grupi i strukturuar kriminal", parashikuar nga nenet 189, 190, 298 dhe 333/a të K.Penal.
- 13- Zamira (Roza) Xhafaj**, e bija e Trifon dhe e Sofije, e datëlindjes 16.07.1962, lindur në Seman, Fier dhe banuese në Vlorë, e martuar, me shtetësi shqiptare.
E dyshuar: Për kryerjen e veprave penale "Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave", "Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve", "Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve", "Grupi i strukturuar kriminal", parashikuar nga nenet 189, 190, 298 dhe 333/a të K.Penal.
- 14- Bedri Meta**, i biri i Zenel dhe i Hike, i datëlindjes 20.01.1967, lindur në Nikël, Krujë dhe banues në Krujë, i martuar, me shtetësi shqiptare.
I dyshuar: Për kryerjen e veprave penale "Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave", "Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve", "Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve", "Grupi i strukturuar kriminal", parashikuar nga nenet 189, 190, 298 dhe 333/a të K.Penal.
- 15- Aleksia (Mimoza/Roksana) Kamaj**, e bija e Agur dhe e Asije, e datëlindjes 01.02.1984, lindur në Fshatin Usoj, Fier dhe banuese në Mallakaster, beqare, me shtetësi shqiptare.
E dyshuar: Për kryerjen e veprave penale "Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave", "Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve", "Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve", "Grupi i strukturuar kriminal", parashikuar nga nenet 189, 190, 298 dhe 333/a të K.Penal.
- 16- Gjergji Mëzuraj (alias Jorgo Karavoqiri)**, i biri i Barjam dhe i Hamite, i datëlindjes 30.06.1973, lindur dhe banues në Vlorë, i martuar, me shtetësi shqiptare.
I dyshuar: për kryerjen e veprave penale "Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave", "Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve", "Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve", "Grupi i strukturuar kriminal", parashikuar nga nenet 189, 190, 298 dhe 333/a të K.Penal
- 17- Shuaip Shero**, i biri i Sali dhe i Ildize, i datëlindjes 28.01.1954, lindur në Konispol, Sarandë dhe banues në Sarandë, i martuar, me shtetësi shqiptare.
I dyshuar: Për kryerjen e veprave penale "Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave", "Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve", "Ndihma për kalim të

paligjshëm të kufijve”, “Grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga nenet 189, 190, 298 dhe 333/a të K.Penal.

18- Afrim Emini, i biri i Emin dhe i Shuqurane, i datëlindjes 24.07.1972, lindur në Konispol, Sarandë dhe banues në Sarandë, i martuar, me shtetësi shqiptare.

I dyshuar: Për kryerjen e veprave penale “Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave”, “Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve”, “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve”, “Grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga nenet 189, 190, 298 dhe 333/a të K.Penal.

19- Ermal Mema, i biri i Fadil dhe i Lavdije, i datëlindjes 22.01.1988, lindur në Levan, Fier dhe banues Fier, i martuar, me shtetësi shqiptare.

I dyshuar: Për kryerjen e veprave penale “Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave”, “Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve”, “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve”, “Grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga nenet 189, 190, 298 dhe 333/a të K.Penal.

20- Avni Lezaj, i biri i Fitim dhe i Zene, i datëlindjes 20.05.1967, lindur në Shoshaj, Burrel dhe banues në Krujë, i martuar, me shtetësi shqiptare.

I dyshuar: Për kryerjen e veprave penale “Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave”, “Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve”, “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve”, “Grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga nenet 189, 190, 298 dhe 333/a të K.Penal.

21- Ilia Margo, i biri i Nikolla dhe i Athina, i datëlindjes 24.09.1960, lindur në Memaliaj, Përmet dhe banues në Gjirokastër, i martuar, me shtetësi shqiptare.

I dyshuar: Për kryerjen e veprave penale “Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave”, “Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve”, “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve”, “Grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga nenet 189, 190, 298 dhe 333/a të K.Penal.

22- Sefer Çelo, i biri i Asllan dhe i Harzo, i datëlindjes 26.07.1964, lindur në Lazarat banues në Gjirokastër, i martuar, me shtetësi shqiptare.

I dyshuar: Për kryerjen e veprave penale “Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave”, “Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve”, “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve”, “Grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga nenet 189, 190, 298 dhe 333/a të K.Penal.

23- Janaq Gramozi, i biri i Nikolla dhe i Sofia, i datëlindjes 30.04.1950, lindur në Dermish, Sarandë dhe banues në Delvinë, i martuar, me shtetësi shqiptare.

I dyshuar: Për kryerjen e veprave penale “Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave”, “Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve”, “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve”, “Grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga nenet 189, 190, 298 dhe 333/a të K.Penal.

24- Mentor Mici, i biri i Vesel dhe i Sadete, i datëlindjes 02.03.1988, lindur në Bushtricë, Kukës dhe banues në Dushk, Lushnjë.

I dyshuar: Për kryerjen e veprave penale “Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave”, “Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve”, “Ndihma për kalim të

paligjshëm të kufijve”, “Grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga nenet 189, 190, 298 dhe 333/a të K.Penal.

25- Dashnor Tafani, i biri i Haki dhe i Tushe, i datëlindjes 25.05.1969, lindur dhe banues në Belsh, Elbasan, i martuar, me shtetësi shqiptare.

I dyshuar: Për kryerjen e veprave penale “Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave”, “Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve”, “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve”, “Grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga nenet 189, 190, 298 dhe 333/a të K.Penal.

26- Françesk Meta, i biri i Fatmir dhe i Merita, i datëlindjes 24.06.1995, lindur në Elbasan dhe banues në Elbasan, beqar, me shtetësi shqiptare.

I dyshuar: Për kryerjen e veprave penale “Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave”, “Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve”, “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve”, “Grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga nenet 189, 190, 298 dhe 333/a të K.Penal.

27- Enver Muka, i biri i Nuredin dhe i Dile, i datëlindjes 25.01.1963, lindur dhe banues në Kallm, Fier dhe banues në Fier, i ve, me shtetësi shqiptare.

I dyshuar: Për kryerjen e veprave penale “Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave”, “Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve”, “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve”, “Grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga nenet 189, 190, 298 dhe 333/a të K.Penal.

28- Besnik Hoxha, i biri i Tetem dhe i Hysnije, i datëlindjes 22.02.1984, lindur në Donofrosë, Berat dhe banues në Berat, i martuar, me shtetësi shqiptare.

I dyshuar: Për kryerjen e veprave penale “Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave”, “Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve”, “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve”, “Grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga nenet 189, 190, 298 dhe 333/a të K.Penal.

29- Çajup Tefa, i biri i Zhuli dhe i Sanije, i datëlindjes 11.04.1971, lindur dhe banues në Gjirokastrë, i martuar, me shtetësi shqiptare.

I dyshuar: Për kryerjen e veprave penale “Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave”, “Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve”, “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve”, “Grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga nenet 189, 190, 298 dhe 333/a të K.Penal.

30- Vejsel Gjolleshi, i biri i Hasan dhe i Xhemo, i datëlindjes 01.01.1969, lindur në Lazarat Gjirokastrë dhe banues në Gjirokastrë, i martuar, me shtetësi shqiptare.

I dyshuar: Për kryerjen e veprave penale “Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave”, “Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve”, “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve”, “Grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga nenet 189, 190, 298 dhe 333/a të K.Penal.

31- Marlen Shoshaj, i biri i Nuredin dhe i Fero, i datëlindjes 07.10.1973, lindur në Asim Zeneli, Gjirokastrë dhe banuese në Gjirokastrë, i martuar, me shtetësi shqiptare.

I dyshuar: Për kryerjen e veprave penale “Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave”, “Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve”, “Ndihma për kalim të

paligjshëm të kufijve”, “Grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga nenet 189, 190, 298 dhe 333/a të K.Penal.

32- Vangjel Gramozi, i biri i Pilo dhe i Theodhora, i datëlindjes 02.05.1965, lindur në Përmet dhe banues në Sarandë, i martuar, me shtetësi shqiptare.

I dyshuar: Për kryerjen e veprave penale “Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave”, “Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve”, “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve”, “Grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga nenet 189, 190, 298 dhe 333/a të K.Penal.

33- Idi Mita, i biri i Marenglen dhe i Qamile, i datëlindjes 26.02.1984, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, i martuar, me shtetësi shqiptare.

I dyshuar: i dyshuar për kryerjen e veprave penale “Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave”, “Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve”, “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve”, “Grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga nenet 189, 190, 298 dhe 333/a të K.Penal.

34- Mehmet Cani, i biri i Dervish dhe i Sheqere, i datëlindjes 25.02.1971, lindur dhe banues Kajan, Belsh, Elbasan, me shtetësi shqiptare.

I dyshuar: Për kryerjen e veprave penale “Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave”, “Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve”, “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve”, “Grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga nenet 189, 190, 298 dhe 333/a të K.Penal, masa e sigurimit personal “*arrest në burg*” të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale.

35- Erlis alias Manxhar Shehu, i biri i Qani dhe i Lumturi, i datëlindjes 10.08.1983, lindur dhe banues në Krahës, Tepelenë, Beqar, me shtetësi shqiptare.

I dyshuar: Për kryerjen e veprave penale “Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave”, “Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve”, “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve”, “Grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga nenet 189, 190, 298 dhe 333/a të K.Penal, masa e sigurimit personal “*arrest në burg*” të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale.

36- Elmas Bilbili, i biri i Brahim dhe i Lefteri, i datëlindjes 17.11.1991, lindur në Fshatin Toç, Tepelenë dhe banues në Tepelene, (aktualisht me detyrë punonjës policie), beqar, me shtetësi shqiptare.

I dyshuar: Për kryerjen e veprave penale “Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave”, “Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve”, “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve”, “Grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga nenet 189, 190, 298 dhe 333/a të K.Penal masa e sigurimit personal “*arrest në burg*” të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale.

OBJEKTI: Caktimi i masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues “*arrest në burg*”, e parashikuar në nenin 238 të Kodit të Procedurës Penale.

BAZA LIGJORE: Nenet 228, 229, 230, 238, 244/1 të Kodit të Procedurës Penale.

Gjykata, në dhomë këshillimi pasi shqyrtoi kërkesën, mori povat dhe aktet e paraqitura, si dhe pasi vlerësoi çështjen në tërësi;